



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:032361

Datë: 01.04.2021

Numri i dokumentit: 01655910

P.nr. 244/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM, sipas Gjyqtarit të vetëm gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Selvane Bukleta, në çështjen penale kundër të pandehurit B. B. nga, me vendbanim në rr “.....”, Kompleksi, kati I, për veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, nga neni 401 par.5, lidhur me par.1, të KPRK-së, sipas aktakuzës së PP/II.nr.378/20, të dt. 28.02.2020, pas mbajtjes së seancës publike të shqyrtimit fillestar, të dt.08.03.2021, në praninë e Prokurorit të Shtetit Astrit Gashi, i pandehuri B. B., mbrojtësja e tij av. H. M., i caktuar sipas detyrës zyrtare, në të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.17.03.2021, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

B. B., i lindur me dt., në, me vendbanim në rr “.....”, Kompleksi, kati I, i biri i M. dhe nënës M., e gjinisë M., i njohur sipas nr. personal, ka të kryer shkollën e mesme, imartuar, baba i 3 fëmijëve, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, posedon tel.nr....., i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak, nga dt. 22.02.2020, e gjer me dt.22.03.2020, tani mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

- Me dt. 22.02.2020 rreth orës 21:00 min, në rrugën ”.....” në, me kanosje serioze , pengon personin zyrtar dhe atë kapiteni E. Ll. në kryerjen e detyrave zyrtare në atë mënyrë që natën kritike gjer sa patrulla policore në përbërje të Kapitenit E. Ll. dhe dëshmitarët hetuesit policor H. S. dhe A. V. ishin duke kryer kontrollin ndaj parkingjeve të pa rregullt pikërisht para lokalitkishin vërejtur veturën e të

pandehurit me targa te Italisë dhe pasi policia kërkojnë dokumentacionin dhe kërkojnë sekuestrimin e veturës me qëllim të dërgimit ne dogane, aty vëren kapitenin E. i cili ishte ne veture dhe me te njëjtin është fqinje dhe i drejtohet me fjale “se ti E. je ka ma bene për inati dhe kam me ta thy kryt” ku me te dëgjuar këto fjale kapiteni E. jep urdhër qe te arrestohej dhe pasi sjellët ne stacionin policor ne prezencën edhe te dëshmitarit hetuesit policor A. S. ju drejtohet me fjalë” se si te lirohet mbas 48 orëve paraburgimi do ta vras E. ne pragë te derës se shtëpisë ne prani te gruas se tij.

-Me çka ka kryer vepër penale pengim i personit zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5, lidhur me par.1, të KPRK-së.

Andaj gjykata në aplikim të në nenin 7, 38, 39, 46,47,48,49, 69 dhe nenit 401 par.5 lidhur me par.1 te KPRK-së, nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

DËNIM ME KUSHT

Me dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, e ne te cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak, nga data 22.02.2020 deri me date 22.03.2020, mirëpo ky dënim nuk do të ekzekutohet në rast se i pandehuri brenda periudhës 1 (një) vjeçare nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

I pandehuri obligohet në pagimin e shpenzimeve te procedurës penale ne shumë prej 50 (pesëdhjete) euro, dhe te paushallit gjyqësor ne shumen prej 20 (njëzet) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari E. Ll. për realizimin e kërkesës pasurore udhëzohen ne kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.378/20, të dt. 28.02.2020, kundër të pandehurit B. B. nga, për shkak te veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, nga neni 401 par.5, lidhur me par.1, të KPRK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 08.03.2021, është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar dhe prezent ishin prokurori i shtetit Astrit Gashi, i pandehuri B. B., mbrojtësja e tij av. H. M., e caktuar sipas detyrës zyrtare.

Gjykata konform dispozitave të nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka udhëzuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe se për mbrojtës i është caktuar sipas detyrës zyrtare avokatja H. M..

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale cila i vihet në barrë, i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, pranimin e ka bërë vullnetarisht, ka shprehur pendimin për veprën e kryer, ka premtuar se më nuk do të përsëris vepra tjera penale, ka shtuar se i ka kërkuar falje të dëmtuarit, nuk kanë më asnjë problem.

Mbrojtësja e të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të saj, meqenëse është pranim i vullnetshëm dhe pa kurrfarë presioni. Meqenëse i njëjti e pranoi fajësinë, i propozon gjykatës që këtë pranim të fajësisë të merr si rrethanë lehtësuese, është hera e parë që bie ndesh me ligjin, është mbajtës i familjes, i ka kërkuar falje policisë dhe të dëmtuarit, edhe i dëmtuari e ka pranuar kërkim faljen, ashtu që nuk kanë asnjë problem me të dëmtuarin.

Gjyqtari i vetëm gjykues, ka marrë mendimin nga Prokurori i Shtetit, ku prokurori i shtetit është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit nga se shihet së është i vullnetshëm dhe në përputhje me shkresat e lëndës. Gjykatës i propozon që ta pranojë pranimin e fajësisë nga ana e të njëjtit dhe të merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza siç janë: raporti i hetuesit policor H. S. dhe A. V. i dt. 22.02.2020, raporti i hetuesit policor të dëmtuarit kapitenit E. Lluka, raporti i hetuesit policor A. S. , raporti i hetuesit policor A. V., deklarata e të pandehurit B. B. e dhënë në polici me dt. 23.02.2020, dëftesa mbi konfiskimin e pronës të dt. 22.02.2020, raporti mbi të kaluarën kriminale për të pandehurin, deklarata e dëshmitarit hetuesit policor H. S. e dhënë në prokurori me dt. 25.02.2020, deklarata e dëshmitarit hetuesit policor A. V. e dhënë në prokurori me dt. 25.02.2020, deklarata e të dëmtuarit E. Ll. e dhënë në polici me dt. 27.02.2020, si dhe shkresat tjera të lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit B. B., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare, nga neni 401 par.5, lidhur me par.1, të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri ishte i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe atë e ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë, pendimin për veprën e kryer dhe premtimin se ne te ardhmen nuk do te kryej vepra tjera penale, ndërsa rrethana rënduese gjykata gjeti se i njëjti me pare ka qene i dënuar për vepër tjetër penale.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 dhe 2.7 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.1, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit i udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM,
P.nr.244/20 dt. 17.03.2021**

Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta

GJYQTARI
Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate